



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:066749  
Datë: 02.05.2024  
Numri i dokumentit: 05646561

KPPP.nr. 788/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.SH "Nina Boxes", me numër unik identifikues 810882911 dhe me seli në Prishtinë, Veternik, Zona e Re Industriale, kundër debitorit "M-Media Solutions" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810838550 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Behar Begolli", p.nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mehmet Berisha, avokat nga Prishtina, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 209/23, i lejuar me datë 02.05.2023, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit "M-Media Solutions" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810838550 dhe me seli në Prishtinë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 209/23, i lejuar me datë 02.05.2023, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj,.
- Urdhri Përmbartimor P.nr. 209/23, i lejuar me datë 02.05.2023, nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës nr. 1270/22, e datës 08.11.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 209/23, të datës 02.05.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 5,404.40, me kamatë ligjore prej 8 %, shpenzimet e tjera të krijuara, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e pasojave ligjore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marrë urdhri përmbartues nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe i njëjti nuk është dorëzuar në formën e përcaktuar me Ligjin për Procedurën Përmbartimore. Ka shtuar se propozimit për përmbartim duhet t'i bashkangjitet dokumenti i besueshëm në origjinal apo kopje të vërtetuar sipas ligjit, e poashtu fatura nuk përmban kohën e përmbushjes së detyrimit monetar ashtu siç parashihet me nenin 29, par. 3 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se fatura nuk është pranuar nga debitori, nuk është nënshkruar apo vulosur me vulën e kompanisë nga ana e debitorit, duke u lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se debitori në prapësimin e tij nuk e ka mohuar borxhin që ka ndaj kreditorit dhe qëllimi i tij është shtyrja e pagesës së borxhit. Më tej, ka theksuar se fatura është në origjinal, e pranuar nga debitori si pranues i shërbimit përmes komunikimit elektronik dhe se fatura është e deklaruar në ATK si faturë e rregullt. Ka shtuar se të gjitha pretendimet e paraqitura në prapësim janë të pa bazuara, jo relevante, duke mos u mbështetur në prova, si dhe duke qenë se fatura i është dërguar në email debitorit, përfaqësuesi i debitorit F.K. përmes komunikimit elektronik e ka konfirmuar pranimin e faturës dhe shërbimin e eventit, si dhe ka deklaruar se do e paguajë. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, "*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: "*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të*

*besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*".

Gjykata vlerëson se përmbaruesi privat ka lejuar urdhrin përmbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 1270/22, e datës 08.11.2022, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Tutje, Gjykata gjen se fatura i është dorëzuar debitorit përmes komunikimit elektronik të datës 14.03.2023 si dhe datës 25.04.2023, ndërsa debitori, po ashtu përmes komunikimit elektronik ka konfirmuar pranimin e faturës duke pohuar edhe detyrimin që rrjedh nga fatura e lartcekur.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 788/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.